

## KERKESE -PADI

**PADITES:**

**1. Partia Bindja Demokratike (BD)**

Adresa: Rruga e Elbasanit, ndertesa 5, hyrja 2/11001 Tirana, Albania.

**2. Edmond PIROLI**, i biri Nikoll dhe i Age, i datëlindjes 09.04.1984, lindur dhe banues ne Zheje, Kurbin, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, me zotësi te plote për te vepruar, me cilësinë e kandidatit për Kryetar Bashkie ne Bashkine Kurbin, si përfaqësues i forcës politike Bindja Demokratike. Përfaqësuar me prokure nga Av. **Islam Ismajli** dhe Av. **Kastriot Lika** Tel 0686386946

**I PADITUR:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**P/INTERESUAR:**

Partia Socialiste e Shqiperise, Aleanca për Shqiperine Europiane (ASHE)

**OBJEKTI:**

Shfuqizimin e vendimit nr. date 10.07.2019 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Shpalljen e pavlefshmërisë se zgjedhjeve ne te 76 qendrat e votimit ne KZAZ 15 për Bashkine Kurbin, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve

**B/LIGJORE:**

Neni 153, dhe 124, 124/4, 125, 126 e vijues si dhe nenet 160 e 161 te K.Zgjedhor


### **DREJTUAR GJYKATES SE APELIT TIRANE KOLEGJIT ZGJEDHOR**

#### **Te nderuar Gjyqtare!**

Ne paditësit subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike dhe kandidati për Bashkinë Kurbin paditësi **Edmond Piroli**, kemi depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr.26 regj, datë 05.07.2019.

Në mbledhjen e datës 06.07.2019, ora 11:00 pas relatimit dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike u konstatua se kjo kërkesë ankimore nuk i përmbante elementet e formës duke mos plotësuar një nga kërkesat e nenit 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor sipas vete verifikimeve paraprake nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vendosi me Vendimin nr. 967 datë 06.07.2019 "Kthimin për plotësim të kërkesës ankimore nr.26 , paraqitur në KQZ në datën 05.07.2019" sipas nenit 129





pika 3 "c" e Kodit Zgjedhor. Ne si subjekt ankues, brenda afatit ligjor dhe sipas kërkesave të vendimit të KQZ-së kemi depozituar në KQZ kërkesën ankimore të plotësuar.

Në mbledhjen e datës 09.07.2019, ora 10:00, u verifikua plotësimi i dokumentacionit të Kërkesës Ankimore dhe rezultoi se Kërkesa Ankimore ishte në përputhje me parashikimin e Nenit 129 pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe u vendos kalimi i saj për shqyrtimin në themel. Ndërsa me vendimin e datës 10.07.2019 objekt ankimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të rrëzimin e kërkesës ankimore me pretendimin se nuk ka prova në procesverbalet e zonës zgjedhore.

E kundërshtojmë vendimin e KQZ, pasi është një vendim i pabazuar në ligj dhe në prova dhe cenon rëndë parimin kushtetues të drejtës për të zgjedhur, dhe gjithashtu për të zgjedhur, pasi me provat e paraqitura nga ana jone, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga ana e KQZ, provohet katërçipërisht se rezultati zgjedhor nuk vjen si rezultat i votimeve zgjedhore por si rezultat i votimeve dhe mbivotimeve të bëra nga vete komisionerët zgjedhor të subjektit tjetër politik, ku rezultati përfundimtar zgjedhor ka treguar se në kutitë e votimit në të 76 QV-te ka patur me shumë vota se votues, dhe sasia e votave të shtuara është me shumë se numri i votuesve reale.

Gjate zgjedhjeve vendore të 30 Qershorit 2019, në si subjekt zgjedhor dhe pale pjesëmarrëse në këtë proces kemi konstatuar një sërë shkeljesh gjate procesit të votimit dhe numërimit të votave, shkelje të cilat janë shumë të rënda, dhe që kanë ndikuar drejtperdrejte në procesin zgjedhor duke deformuar vullnetin e votuesve Kurbinas. Për më tepër këto shkelje janë jo vetëm të karakterit administrativ, por janë edhe të karakterit penal, për të cilën ne kemi bërë menjëherë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku kjo e fundit ka bërë regjistrimin e procedimit penal nr. 228 të vitit 2019 për veprën penale të "Falsifikimit të materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve" të parashikuar nga neni 326 i K.Penal<sup>1</sup>. Pra pasojat e këtyre shkeljeve në të 76 Q.V, jo vetëm që ka cenuar rëndë procesin zgjedhor për Bashkinë Kurbin, duke parapërcaktuar si kryetar një kryetare jolegjitime, por në aspektin penal veprimtaria kriminale e mireorganizuar nga subjekti politik kundërshtar nëpërmjet komisionereve të të 76 Q.V-ve kanë krijuar edhe produkte të veprës penale sic janë dokumentacioni zgjedhor i përfutur nga procesi zgjedhor në teresi.

E kemi kundërshtuar rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve duke kërkuar edhe shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në të 76 qendrat e votimit të KZAZ nr. 15, pasi në të 76 qendrat provohet që kanë "votuar" persona të cilët me datë 30.06.2019 nuk kanë qene fizikisht në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ne kemi evidentuar në terren në menyreinvestigative se numri i personave që nuk kanë qene prezent por që rezultojnë të kenë votuar shkon në mbi 650 vete. Mesatarisht i takon rreth 9 persona për çdo Qender Votimi. Rezulton gjithashtu se të afërmit e komisionereve, një pjese e punonjësve të sistemit arsimor, edukatorët e kopshteve, mësuesit e fillores kanë qene me të ndikuar dhe na ka rezultuar nëpërmjet dëshmimeve të tyre se kanë qene të detyruar, jo vetëm që të paraqiteshin vete në QV por njëkohësisht ishin të shantazhuar që të merrnin me vete edhe kartat e identitetit të të afërmeve të tyre apo invalidë të

<sup>1</sup>Shih shkresën nr. 4854 Prot. dt. 03.07.2019 të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Kurbin



cilët nuk e ushtronin dot procesin e votimit por janë asistuar te votonin ne kundërshtim me vullnetin e tyre.

Me lejoni te shpjegoj mekanizmin sesi është votuar:

Për personat që ishin jashtë shtetit kane dërguar ne menyre elektronike kopje dokumentash identifikimi nëpërmjet programeve whatsapp, messenger, viberetj dhe për ta kane votuar vete komisioneret dhe me se shumti ne baze te te dhënave investigative rezulton se nënshkrimet janë kryesisht te kryetareve dhe anetareve te tjerë. Ndërsa ne lidhje me personat që nuk janë paraqitur fizikisht për shkaqe te ndryshme, personat e shantazhuar kane marre mjetet e identifikimit te te afërmeve te tyre, kryesisht punonjësit e administratës publike. Ky fakt provohet katërçipërisht për shkak se ne 10 raste disponohen pamjet filmike te marra ne ambjentet që e QV-ve, qendra te cilat janë 0856, 0856/1, 0857, 0857/1, 0848, 0908, 0911, 0911/1, 0920, 0920/1.

Ditën e zgjedhjeve, nga ankimimet e qytetareve te cilët përfitojnë ndihme ekonomike janë telefonuar nga punonjësit e zyrës se ndihmës ekonomike nëpërmjet numrave

- 0694783643
- 0685178371

Këta punonjës te administratës publike te territorit te Kurbinit kane shantazhuar dhe kërcënuar për votimin jo vetëm te tyre por edhe te familjareve e te afërmeve te tyre që nëse nuk marrin pjese do te përjashtoheshin për 4 vitet e ardhshme nga skema e ndihmës ekonomike. Këto telefonata janë kryer ne menyre intensive nga datat 24.06.2019-30.06.2019, dhe ky fakt është referuar edhe ne prokurori. Shumica e këtyre familjeve kane devijuar vullnetin e tyre duke votuar ne favor te kandidatës kundërshtare.

Referuar vendimit nr. 353 dt.02.07.2019 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse te rezultatit për zgjedhjet e kryetarit te Bashkise Kurbin" konstatohet se komisioneret e numërimit te votave kane bere rreth 570 vota te pavlefshme duke i dëmtuar gjate numërimit pasi nuk na kane lejuar as komisionere dhe as vëzhgues.

Edhe pse ne pretenduam që te paktën te kishim njekomisioner ne procesin e numërimit dhe konkretisht kërkua që komisioneri i shoqërisë civile te zëvendësohej me numërues te subjektit Bindja Demokratike, por dhe kjo u refuzua. Po ashtu ne pjesën me te madhe te kohës, komisioneri i shoqërisë civile nuk ka kryer detyrën gjate numërimit dhe nuk ka marre pjese aktivisht ne numërim, pasi krimi elektoral ka shkuar deri aty sa te eliminoheshin edhe numëruesit e shoqërisë civile dhe për pjesën me te madhe te zonave numëruesi i shoqërisë civile ishte simpatizant i subjektit tjetër politik Partia Socialiste e Shqiperise. Praktikisht une kandidati për kryetar për Bashkine Kurbin kuptova se vijonte procesi i ndryshimit te rezultatit te zgjedhjeve jo vetëm ne QV por edhe ne KZAZ.

Rezulton plotësisht e provuar se ne te 76 qendrat e votimit, ne listat e zgjedhësve janë specimente te nënshkruara nga komisioneret dhe sipas verifikimeve tona rezulton se nga vete komisioneret është nënshkruar ne mbi 2300 raste pasi faktikisht kane votuar ne 76 QV vetëm 4370 persona që janë paraqitur fizikisht për te votuar. Ndersa diferenca tjetër e votave ne raport



me rezultatin përfundimtar të pjesëmarrjes është shtuar në mënyrë fiktive nga vete komisionerët për të rritur % e pjesëmarrjes dhe numrin e votave në favor të kandidatës kundërshtare.

Gjatë ditës së votimeve, më 30 Qershor 2019 është konstatuar fotografimi i votave nga personat e kërcënuar për të ruajtur pozicionin e punës dhe konkretisht në QV nr. 0857/1 është kapur shtetasi Edmond Mara, fakt i cili është dokumentuar dhe referuar në prokurorinë kurbin në raport me procedimin nr. 228 i vitit 2019. Është e provuar se më datë 30 Qershor 2019 kemi dokumentuar se mësuesi Vath Myrto ka shkuar për të votuar në QV nr. 0907 dhe ka paraqitur me vete edhe kartën e bashkëshortes dhe të një komshiu të mësuesin Vath Myrto e kishte kërcënuar drejtpërdrejt kandidatja e Partisë Socialiste Majlinda Cara (ish-drejtoreshë e Z.A Kurbin), pasi këtij mësuesi një vit më përpara ajo i kishte hequr nga puna bashkëshorten. Ky fakt provohet lehtë po të verifikohet specimenti i nënshkrimit të bashkëshortes dhe të komshiut.

Po në këto qendër vëzhguesi jone Jakup Stafa është lejuar për të dhënë ndihmë 4 të moshuarve të cilët deklarorin se nuk janë në gjendje të votojnë në mënyrë të pavarur por çuditërisht në këto Q.V kemi dalë me 0 vota. Vëzhguesi jone, jo vetëm na e ka referuar këtë fakt por edhe ka bërë deklaratë noteriale në të cilën deklarorin ato që thamë më sipër.

Vëzhguesi jone Enver Diva i QV nr. 0905 ka kapur kryetarin e komisionit të quajtur Lume Mema me detyrë Faturiste të OSHEE duke futur vota në favor të kandidatës kundërshtare. Në moment kemi marrë masa për bllokimin e Q.V dhe nga ana jone është njoftuar Kryetari i Partisë Bindja Demokratike Z. Astrit Patozi, ngjarje e cila ka ndodhur rreth orës 14.

Vëzhguesi jone Bledar Lika i cili ka qenë në QV nr. 0884 është paraqitur si vëzhgues atje por e kanë përzënë dhe nuk e kanë lejuar që të kryejë detyrat e tij për arsye se zoti Bektash Zeneli me detyrën e punonjësit të bashkisë në marrëdhëniet me publikun, kishte plan të mireorganizuar për futjen dhe shtimin e numrit të votave në favor të kandidatës tjetër. Vëzhguesi jone në distancë ka konstatuar se kanë marrë pjesë fizikisht 25 vete ndërsa në kuti na rezultojnë 75 vota që do të thotë se janë shtuar plotësisht 50 vota fiktive, veprim i organizuar nga shtetasi Bektash Zeneli.

Në Qendrat e Votimit të Gurrezit, nën ndikimin e shtetasit Leonard Ujka Komisionerët e KQV-ve 0899 dhe 0899/1 kanë pranuar fotokopje kartash identiteti të personave jashtë shteti dhe që figurojnë të kenë votuar.

Për të gjithë personave që ndodhen jashtë shtetit i kemi drejtuar me kërkesë Komisarariatit të Policisë Kurbin për të na vënë në dispozicion informacionin e kërkuar për këta votues duke ju referuar sistemit Tims, por nuk kemi marrë akoma përgjigje, prandaj ky informacion duhet të verifikohet edhe në rrugë administrative nga KQZ.

Në QV nr. 0908 është votuar për një fis të tërë nga vete komisioni nën influencën e drejtuesve të administratës, megjithëse gjysma e atij fisi gjenden jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në orën 03:00 të datës 01.07.2019 pasi më parë u përballëm me arbitraritetin e KZAZ nr. 15 njoftuam Prokurorin e rrethit Kurbin z. Arben Nika për të administruar provat e krimit zgjedhore që kishin bërë kryesisht Komisionerët e 76 qendrave të votimit. Prokurori nuk u paraqit dhe nuk dërgoi as OPGJ por më orjentoj mua Kandidatin që të paraqitesha në Komisarariatit të Policisë Kurbin. U paraqita në Komisarariat dhe gjeta rezistencë të pa parë dhe presion për mos të bëje



kallzim penal dhe me thane që duhet te paraqitesha ne orën 09<sup>00</sup> te datës 1/07/2019. Ne kete moment njoftova Av Islam Ismailin i cili me tha merr masa njofto z Astrit Patosi dhe Ministrin e Brendshem dhe KQZ. Pasi me dëgjuan se çfarë po bisedoja me Avokatin me ftuan te beja kallëzimin. Nga ai moment për çudin time lëvizin drejt zonës se Fush Kuqes furgoni i Policies i cili u shoqërua me lëvizjen e Av.Edmond Buna djali i Tezes se kandidates. Konstatuam nje perfeksion koordinues te lidhjeve midis QV Fush Kuqe, Kzaznr 15, Policise Kurbin dhe përfaqësues te Kandidates dhe ajo personalisht ku del e qarte se votat e këtyre qendrave votimi janë plotësisht te rakorduara (kamerat nuk janë prekur). Ne kete moment për te na larguar nga ndjekja e problemit u deklarua se numerimi do te fillonte ne orën 09 te datës 01/07/2019 dhe neve nuk mundem te ndjeknim nga afër problematiken e konstatuar. Meqenëse ne deklaruar që te bllokohej vetëm QV e Fush Kuqes shpresojm që mos te kete pasur koordinacion veprimesh për qendrat e tjera që kanëpase kamera vëzhgimi ku janë dyfishuar numri i fletëve te votimit pasi votuesit i kemi numeruar me laps ne dore tek hynin neper qendrat e votimit.

Nisur nga sa me sipër duke ju referuar nenit 160 te K.Zgjedhor rezultojnë te provuara se ne te 76 qendrat e votimit pjese përbërëse te KZAZ nr. 15 kemi patur shkelje te renda te procesit te votimit dhe te numërimit te cilat kane ndikuar ne menyre te drejtperdrejte dhe vendimtare ne marrjen e mandatit nga kandidatja kundershatare. Pra vota nuk ka qene e lire ne momentin e ushtrimit te saj, dhe ne rezultatet perfundimtare gjithashtu nuk është pasqyruar ajo që është votuar. I gjithë procesi i votimit ne KZAZ nr. 15 është shenderruar nga nje proces votimi demokratik, ku është votuesi ai që vendos, ne nje proces vetevotimi te centralizuar ku pesha e votave te hedhura nga komisioneret ka qene me e madhe se pesha e votave te hedhura nga vete votuesit e paraqitur fizikisht. Te gjitha këto shkelje justifikojnë dhe përmbushin kriteret e parashikuar nga neni 160/1/a te K.Zgjedhor dhe kerkojnedomosdoshmerisht deklarimin e pavlefshmërisë se zgjedhjeve ne këto QV, pasi i mohojnë sovranitet te drejtën për te zgjedhur. Këto fakte për nga rëndësia e shkeljeve te ndodhura dhe për nga ndikimi kriminal që kane patur janë shprehur ne menyre te menjëhershme edhe ne veprimet e prokurorisë, fakte te cilat duke qene te pakontestueshme e kane bindur kete te fundit që te beje regjistrimin e procedimit penal pa qene e nevojshme ezaurimi i afatit 15 ditor verifikues. Prandaj faktet e mësipërme tregojnë që zgjedhjet ne tërësinë e tyre janë manipuluar ne menyre te mireorganizuar, ne menyre te koordinuar dhe me te njëjtin mekanizëm ne te gjitha QV duke cenuar rende procesin e zgjedhor (votim+numerim) dhe duke i bere këto te pavlefshme.

Si rrjedhoje e kësaj pavlefshmërie i kërkojmë Kolegjit Zgjedhor që te shfuqizojë vendimin e KQZ-se dhe ne baze te nenit 161 te K.Zgjedhorte zgjidhe pasojat e pavlefshmërisë se zgjedhjeve ne KZAZ nr. 15 ne lidhje me bashkinë Kurbin, duke vendosur për perseritjen e zgjedhjeve si te vetmen zgjidhje proporcionale ne raport me shkeljet e procesit zgjedhor kriminal te organizuara subjekti tjetër zgjedhor,

Edhe pse KQZ e cila tashme është kthyer ne nje institucion politik, e ka refuzuar kërkesën tone si te pabazuar ne prova, ju bëjmë me dije se e pabazuar ne prova është vete vendimi i KQZ i cili ka shkelur çdo parim ligjshmërie duke cenuar ne menyre te drejtperdrejte Kodin Zgjedhor. Ju rikujtojmë se sebashku me kërkesën ankimore ne kemi paraqitur si prova edhe aktet si meposhte:

- Liste paraprake te zgjedhësve që kane qene jashtë shtetit me date 30.06.2019, 12 flete



- Memo/kerkese e datës 01.07.2019 te drejtuar Prokurorise Kurbin, 1 flete
- Kerkese e datës 01.07.2019 te drejtuar Prokurorisë Kurbin, 1 flete
- Shkrese nr. 4854 prot UB date 03.07.2019 e Prokurorise Kurbin, 1 flete
- Vendim nr. 353 date 02.07.2019 e KZAZ Kurbin, 1 flete
- Prokure e Pergjithshme nr. 2012 rep dhe nr. 1353 kol e datës 01.07.2019 e përpiluar para noteres Majlinda Gjini, 2 flete
- Tabele përmbledhëse e rezultateve për kandidatet për Kryetar Bashkie Kurbin, 7 flete format A3
- Tabela përmbledhese e rezultateve e rezultateveper kandidatet perKeshillin e Bashkise Kurbin, 9 flete
- Deklarata noteriale e datës 04.07.2019 e bere nga shtetasi JakupStafa, 2 flete
- Deklarata noteriale e datës 04.07.2019 e bere nga shtetasi Enver Diva, 2 flete
- Kerkese drejtuar Komisarariatit te policisë Kurbin e datës 04.07.2019 për marrjen e informacioneve nga sistemi TIMS, 3 flete
- Kerkese drejtuar KQZ me nr. 13197 prot. 3 flete
- Pamjet filmikeper QV nr. 0920 dhe nr. 0920/1

Prandaj vendimi i KQZ është tërësisht i gabuar, joobjektiv, i pambështetur ne prova dhe tërësisht ne cenim te parimeve zgjedhore dhe te K.Zgjedhor, prandaj vendimi duhet te shfuqizohet dhe te deklarohet pavlefshmëria e zgjedhjeve ne te 76 QV pranë KZAZ nr. 15 Kurbin, duke vendosur riperseritjen e zgjedhjeve.

#### **Përfundimisht i kërkojmë Kolegjit Zgjedhor**

- Pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit
- Shfuqizimin e vendimit nr. date 10.07.2019 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
- Shpalljen e pavlefshmërisë se zgjedhjeve ne te 76 qendrat e votimit ne KZAZ 15 për Bashkine Kurbin, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve.

**PADITESA**

**Partia Bindja Demokratike**

Kryetari

**Astrit PATOZI**



**Kandidati Për Kryetar Bashkise Kurbin.**

Edmond PIROLI